



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2021:099202

Datë: 10.06.2024

Numri i dokumentit: 05845297

2023:289240

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, gjyqtari Bekim Salihu, me bashkëpunëtorën profesionale Adelina Idrizi, në çështjen juridike të paditësit R.M. nga Ferizaj, Rr.A.K. Hyrja ..., banesa nr...., Kati ..., të cilin e përfaqëson me autorizim avokat Kemajl Ademaj nga Ferizaj, kundër të paditurës Komuna Ferizaj – Drejtoria e Arsimit, të cilën e përfaqëson S.V., për anulimin e vendimit mbi shkëputjen e kontratës së punës, kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e të ardhurve personale, pas shqyrtimit kryesor të mbajtur më dt.22.04.2024 mori, ndërsa më 03.06.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi kërkesëpadia e paditësit R.M. nga Ferizaj, me të cilën ka kërkuar që të anulohet vendimi i të paditurës Komuna Ferizaj – Drejtoria e Arsimit, nr.... i dt.06.04.2021 mbi shkëputjen e kontratës së punës nr..... të dt.20.03.2015, që paditësin ta kthej në vendin e punës – mësimdhënës në SHML “Z.H.” në Ferizaj, si dhe kompensimin e të ardhurave personale të papaguara që nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës e deri në momentin e kthimit të tij në vendin e punës, me kamatë ligjore prej 8%, **E PABAZUAR**.

II. Secila palë i bartë shpenzimet e veta të procedurës.

A r s y e t i m i

Paditësit me dt.24.05.2021 ka parashtruar padi kundër të paditurës me objekt të kontestit Anulim i vendimit, kthim në vendin e punës dhe kompensim i të ardhurave.

Gjykata lidhur me këtë çështje juridike ka vendosur fillimisht sipas Aktgjykimit C.nr.1058/21, të dt.16.05.2022, me të cilin e ka refuzuar si të pabazuar kërkesëpadinë e paditësit.

Ankesë ndaj këtij vendimi kishte ushtruar përfaqësuesi i të paditësit me datë 08.06.2022.

Gjykata e Apelit në Prishtinë me Aktgjykimin Ac.nr.4530/22 të dt.13.06.2023, refuzuar ankesën e paditësit si të pathemeltë, ndërsa kishte vërtetuar Aktgjykimin e gjykatës së shkallës së parë.

Ndaj aktgjykimit të shkallës së dytë, përfaqësuesi i paditësit në afat ligjor ka paraqitur mjetin e jashtëzakonshëm juridik- revizionin me datë 01.09.2023.

Gjykata e shkallës së tretë në vendosje ndaj revizionit të paditësit, me Aktvendimin Rev.nr. 468/23 i dt. 15.12.2023 përmes së cilit ishte pranuar revizioni i paditësit si i bazuar dhe ishin prishur aktgjykimi i gjykatës së shkallës së dytë Ac.nr.4530/22 i dt.13.06.2023, dhe aktgjykimi i shkallës së parë C.nr.1058/21 i dt. 16.05.2022, dhe lënda i kthehet gjykatës së shkallës së parë në rigjykim.

Në ri procedurë, i autorizuari i paditësit gjatë shqyrtimit kryesor dhe fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë deklarimeve të deritanishme dhe parashtresës për precizimin e padisë, duke kërkuar që kërkesëpadia e paditësit të aprovohet si e bazuar duke kërkuar anulimin e vendimit, si të kundërligjshëm dhe kthimin e paditësit në vendin e tij të punës dhe njohjen e të gjithë të drejtave të tij, duke kërkuar po ashtu edhe t'ia paguaj paditësit pagat dhe të ardhurat personale me kamatë ligjore 8% si dhe shpenzimet e procedurës.

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, në padi gjatë shqyrtimit, në fjalën përfundimtare, dhe në rigjykim ka deklaruar se paditësi tek e paditura ka punuar si mësimdhënës i kulturës fizike që nga data 01.09.1986, fillimisht në Shkollën Fillore "O.M." në F., pastaj në Shkollën e Mesme "Pjetër Bogdani" në Ferizaj dhe së fundi në Shkollën e Mesme "Zenel Hajdini" në Ferizaj, mirëpo, e paditura, me vendimin nr.950 të dt.06.04.2021, papritmas i'a ka ndërprerë paditësit marrëdhënien e punës, me arsyetimin se ndaj tij është duke u zhvilluar procedurë disiplinore dhe sipas shkeljeve të paraqitura nga drejtoria e shkollës dhe të vërtetuara nga ana e komisionit, është vendosur t'i ndërprehet marrëdhënia e punës paditësit. I autorizuari i paditësit deklaroi se marrëdhënia e punës paditësit i është ndërprerë nga e paditura, pa i respektuar procedurat ligjore dhe procedurën disiplinore ndaj tij e ka zhvilluar në kundërshtim me Ligjin e Punës të Kosovës, Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë si dhe Rregullores disiplinore dhe materiale të punëtorëve të arsimit të Komunës së Ferizajt, ngase nuk e ka njoftuar me shkrim punëmarrësin, në këtë rast paditësin lidhur me performancën e pakënaqshme, nuk e ka njoftuar paraprakisht

lidhur me ndërprerjen e marrëdhënies së punës, e gjithashtu në vendimin mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës nuk janë arsyetuar shkaqet e as bazueshmëria ligjore e ndërprerjes së marrëdhënies së punës, tutje, nuk e ka njoftuar përfaqësuesin e SBASHK-ut për të marrë pjesë si vëzhgues gjatë zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj punëmarrësit – paditësit, nuk ka sjellë asnjë fletëparaqitje – njoftim mbi inicimin e procedurës disiplinore dhe nga kjo e fundit e ka privuar paditësin nga mundësia për të vlerësuar nëse me rastin e zhvillimit të procedurës disiplinore do të kishte vend për ta pezulluar procedurën për shkak të vjetërsimit të shkeljes disiplinore. Andaj, nga arsyet e lartë përmendura, i propozon gjykatës që ta aprovoj në tërësi kërkesëpadinë e paditësit si të bazuar, ta anuloj vendimin e të paditurës nr...., të dt.06.04.2021 mbi ndërprerjen e marrëdhënies së punës, ta detyroj të paditurën, që paditësin ta kthej në vendin e tij të punës si mësimdhënës i kulturës fizike në Shkollën “Zenel Hajdini” në Ferizaj, me të gjitha të drejtat nga marrëdhënia e punës, njëherit, ta detyroj të paditurën që paditësit t’ia paguaj pagat – të ardhurat personale nga dita e ndërprerjes së marrëdhënies së punës e deri në momentin e kthimit të tij në punë dhe detyra të punës, me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e arritjes për secilën pagë veç e veç, deri në pagesën përfundimtare. I ka kërkuar shpenzimet e procedurës.

I autorizuari i të paditurës, në përgjigjen e tij në padi, gjatë shqyrtimit, në fjalën përfundimtare dhe në rigjykim ka deklaruar se e kundërshton në tërësi padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar, duke deklaruar se para së gjithash se padia është paraqitur pas afatit ligjor, pasi që vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës është nxjerr më dt.06.04.2021 ndërsa paditësi ankesën e ka paraqitur më dt.07.05.2021, kurse padinë e ka paraqitur në gjykatë më dt.24.05.2021 dhe të gjitha këto veprim janë të pasafatshme në kuptim të nenit 79 të Ligjit të Punës në Kosovë. Po ashtu i autorizuari i të paditurës deklaroi se iniciimi i procedurës disiplinore kundër paditësit R.M., ka filluar nga drejtori i Shkollës “Zenel Hajdini” në Ferizaj, sipas shkresës me nr. të protokollit ..., të dt.27.11.2019, me të cilën shkresë në mënyrë konkrete janë paraqitur arsyet për fillimin e procedurës disiplinore, siç janë ankesat e nxënësve për dhunë fizike dhe ngacmime seksuale ndaj nxënësve, të cilat veprime janë dëshmuar me deklaratat e tyre nga nxënësja Sh.B., M.R., Sh.L., R.R., F.R., S.R., F.H., B.T., Sh.B. dhe F.P.. Vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës nr..., i dt.06.04.2021, i Komisionit Disiplinor është me bazë të plotë materialo juridike e themelësia e tij bazohet në dispozitat e Ligjit të Punës dhe konkretisht në dispozitat e Rregullores për përgjegjësinë disiplinore dhe materiale të punëtorëve arsimor të Komunës së Ferizajt me nr.336, të dt.08.12.2014, ku në këtë vendim janë paraqitur në mënyrë konkrete zhvillimi i procedurës disiplinore për shkelje të rënda të detyrave të punës, si dhe

çështje tjera nga e drejta e marrëdhënies së punës si dhe shqiptimi i masës disiplinore. Padiësi po ashtu ka pasur konflikt edhe me kolegun e punës prof. H.Sh., të cilit i ka shkaktuar lëndime trupore, gjë që vërtetohet nga raporti mjekësor i Spitalit të Përgjithshëm në Ferizaj, i dt.21.01.2019, e po ashtu ekziston edhe aktgjykimi penal i plotfuqishëm P.nr.441/16, i dt.03.06.2016, i Gjykatës Themelore në Ferizaj, me të cilën është konstatuar vepra penale e kryer nga padiësi, ku theksohet se i njëjti ka edhe probleme psikike dhe është rekomanduar në ekzaminim psikiatrik. Pra, nga provat materiale që janë në shkresat e lëndës (***të cilat ja prezenton në origjinal gjykatës dhe palës padiëse***), vërtetohet fakti se kemi të bëjmë me shkelje të rënda të detyrave të punës nga ana e padiësit. Nga arsyet e lartë cekura, konsideron se ndërprerja e marrëdhënies së punës së padiësit është bërë në përputhje të plotë me dispozitat ligjore në fuqi, andaj i propozon gjykatës që kërkesëpadinë e padiësit ta refuzoj në tërësi si të pabazuar.

Gjatë procedurës së provave gjykata në shqyrtim të parë ka dëgjuar dëshmitarin A. I. nga Ferizaj, i njëjti kishte deklaruar se është drejtor i Shkollës, ku ka punuar padiësi dhe thekson faktin se kur kishte ardhur në pozitën e drejtorit kishte trashëguar disa dosje penale dhe disiplinore ndaj padiësit dhe të njëjtin e kishte ftuar në zyre për të diskutuar, duke i'a tërhequr vërejtjen me gojë se i njëjti duhet të përmirësoj sjelljet e tij dhe se duhet po ashtu të përmirësoj performancën në vendin e tij të punës, por që i njëjti ishte përgjigjur se ai ka të drejtë të silltet si të dojë brenda rrethojave të shkollës, madje edhe të përdorë dhunë ndaj tyre, pasi që një gjë të tillë i'a lejon ligji. Më tej dëshmitari shton se rasti i fundit kur padiësi kishte bërë shkelje disiplinore ishte në lidhje me një nxënëse ndaj së cilën padiësi ka përdorur dhunë fizike në ambientet shkollore, gjë për të cilën e ka lajmëruar rastin në polici, ky rast është hetuar nga policia dhe prokuroria dhe në të njëjtën kohë i gjithë materiali, dëshmitë rreth ngjarjes janë dërguar me email në DKA në Ferizaj. Për fat të keq procedura ka zgjatur shumë gjatë dhe në ndër kohë padiësi ka kryer edhe shkelje të tjera disiplinore, siç janë ushtrimi i dhunës edhe një herë tjetër ndaj të njëjtës vajzë, pastaj një herë ndaj një djali në sallë të arsimtarëve në prezencë të tyre, po ashtu ka ushtruar edhe ndaj kolegëve të punës, madje ka bërë edhe ngacmime seksuale ndaj nxënësve, për të cilat raste janë njoftuar policia si dhe DKA në Ferizaj. Nga të dhënat e siguruar DKA sipas ligjeve dhe udhëzimeve administrative në fuqi si dhe duke u bazuar në dokumentacionin ekzistues për gjendjen mendore të mësimdhënësit, ka marrë masa disiplinore në cilësi të punëdhënësit, ku është suspenduar dhe i është ndërpre marrëdhënia e punës mësimdhënësit – padiësit. Dëshmitari shton se për procedurën disiplinore nuk është njoftuar me shkrim padiësi por vetëm me gojë dhe gjithashtu shton se nuk ka qenë prezent përfaqësuesi i

sindikates së arsimit gjatë procedurës së shqiptimit të masës disiplinore ndaj mësimdhënësit – paditësit.

Gjykata në procedurë të shqyrtimit të parë gjyqësor kishte dëgjuar edhe dëshmitarin B.B. nga fshati M., Komuna Ferizaj, deklaroi se qysh në vitin 2019, ka pasur ankesa dhe kërkesa për shqiptim të masave disiplinore ndaj paditësit por që atëherë e kishin ftuar paditësin në takim dhe gojarisht i'a kishin shpjeguar shkeljet që i kishte kryer dhe të njëjtit i kishin kërkuar që të përmirësoj sjelljet e tij, por që i njëjti edhe përkundër premtimeve nuk është përmirësuar dhe ka vazhduar me përsëritjen e shkeljeve disiplinore. Pas kësaj dëshmitari, drejtori i shkollës si dhe drejtori i Drejtorisë së Arsimit në Ferizaj janë ftuar në intervistim nga Policia e Kosovës rreth sjelljeve të paditësit, ku kanë kërkuar që ndaj tij të ndërmerren hapa konkret pasi që i njëjti ka bërë probleme dhe Policia është dashur të vijë shpesh tek objekti i shkollës, ku drejtori i kësaj shkolle A.I. vazhdimisht ju ka dhënë materiale të ndryshme të ankesave dhe videoingjizime të nxënësve, prindërve dhe mësimdhënësve lidhur me sjelljet e tij jo të mira. Si Komisioni i kanë ofruar paditësit mundësinë që të transferohet në një shkollë tjetër por i njëjti ka refuzuar vazhdimisht propozimin e drejtorisë së shkollës dhe në fund drejtori i shkollës është detyruar të inicioj procedurën disiplinore, ku fillimisht i është ndaluar qasja tek objekti i shkollës deri në përfundim të procedurës disiplinore pastaj edhe në bazë të dokumentacionit të mëhershme nga klinika e psikiatrisë të vitit 2016 me të cilin është konstatuar se paditësi është diagnostifikuar me sëmundjen psikike F-20, DKA në Ferizaj ka marrë vendim përfundimtar për ndërprerjen e marrëdhënies së punës. Sa i përket nxjerrjes së vendimit për shqiptimin e masës disiplinore të ndërprerjes së marrëdhënies së punës, dëshmitari deklaroi se vendimi është marrë nga Komisioni dhe është i bazuar në dëshmitë e nxënësve, prindërve dhe të mësimdhënësve, e po ashtu edhe të raporteve të policisë, si dhe dokumentacionin e mëhershëm lidhur me sjelljet e profesorit. Për procedurën disiplinore të zhvilluar është mbajtur procesverbal nga Komisioni. Dëshmitari më tej shton se në procedurën e zhvilluar ndaj paditësit nuk ka qenë prezent përfaqësuesi i Sindikatës së Arsimit sepse një gjë e tillë nuk është obligative dhe se paditësi nuk ka kërkuar prezencën e përfaqësuesit sindikal, në të kundërtën, nëqoftëse pala do të kërkonte atëherë ky përfaqësues do të ftohej në proces. Vendimi mbi shqiptimin e masës disiplinore i'a kanë dorëzuar me shkrim mësimdhënësit, në këtë rast paditësit.

Gjykata, me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes faktike të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse parashtruan ato, në procedurën e rigjyimit ka bërë administrimin e provave si në vijim: *procesverbali C.nr.1058/21 i dt. 11.03.2022 mbi administrimin e provave, deklaratat e*

paditësit e dt. 07.02.2022 në formë të shkruar dhe nënshkruar nga paditësi, vërtetimi SHFMU M. F., me nr. ... e dt. 25.08.2015, procesverbali deklarata e dhënë e paditësit para komisioni disiplinor e dt. 26.03.2021, aktvendimi P.nr. 441/2016 i Gjykatës Themelore Ferizaj D.Përgjithshëm –Divizioni Penal i plotfuqishëm i dt. 27.09.2016.

Gjykata, pasi bëri shqyrtimin dhe analizimin e provave të çështjes (*dhe atë shiqimin e tyre në origjinal në prezencë të palëve*), në kuptim të nenit 8 të LPK-së, ka bërë vlerësimin e tyre veç e veç dhe të ndërlidhura mes veti, si tërësi, dhe mbi bazën e bindjes së lirë të krijuar nga shqyrtimi i provave të çështjes, ka vlerësuar se duhej vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Përmes vërtetimit të shkollës SHFMU “O.M.” në F., me nr...., i dt.25.08.2015, vërtetohet se paditësi R.M., ka punuar tek Shkolla “O.M.” në F., nga data 01.09.1986 deri më 02.11.1987, si mësimdhënës i lëndës së edukatës fizike.

Përmes kontratës së punës për mësimdhënës e lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Ferizaj me nr....., e dt.20.03.2015, gjykata vërtetoi faktin se punëtori R.M. ka punuar si profesor i kulturës fizike në SHML “Zenel Hajdini” në Ferizaj.

Përmes formulari për kërkesë-ankesë drejtuar Drejtorisë së Administratës së Përgjithshme të Komunës së Ferizajt nga R.M., i dt.07.04.2021, gjykata ka vërtetuar faktin se një nxënëse në klasë nuk i kishte patikat për lëndën e edukatës fizike dhe kur të gjithë nxënësit kishin dalë nga klasa vetëm ajo qëndronte brenda dhe kishte refuzuar kërkesën e profesorit që të dilte jashtë, ku me këtë rast paditësi e kishte kapur për krahu që ta nxjerrte jashtë klasës por e njëjta kishte refuzuar dhe profesori kishte ndaluar pa e nxjerrë jashtë.

Përmes vendimit të lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Ferizaj me nr...., i dt.29.03.2021, gjykata vërtetoi faktin se punëtorit R.M. mësimdhënës në SHML “Zenel Hajdini” në Ferizaj, i është ndaluar çasja në objektin e Shkollës që nga data 29.03.2021, e deri në një vendim përfundimtar nga Komisioni Disiplinor i DKA-së në Ferizaj, për shkak të zhvillimit të procedurës disiplinore ndaj tij, veprimeve që i ka ndërmarrë si dhe gjendjes psikike të tij të paraqitura nga raportet mjekësore.

Përmes vendimit të lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Ferizaj me nr...., i dt.06.04.2021, gjykata vërtetoi faktin se mësimdhënësit, në këtë rast paditësit R.M. si mësimdhënës në SHML

“Zenel Hajdini” në Ferizaj, i shqiptohet masa disiplinore e ndërprerjes së marrëdhënies së punës për shkak të shkeljeve të përsëritura disiplinore.

Përmes deklaratës së dt.06.11.2019, e dhënë nga nxënësja Sh.B., gjykata vërtetoi faktin se paditësi e kishte ngacmuar me fjalë nxënësen fillimisht duke tentuar që të bisedonte me të, pastaj kur ajo kishte refuzuar ky e kishte kërcënuar se do ta godiste me shuplakë, pastaj kishte kërkuar nga ajo që të pajtoheshin dhe i kishte hapur krahët që ta përqafoje, madje edhe ia kishte hedhur krahun mbi supet e saj. Në një rast tjetër profesori e kishte pyetur nxënësen nëse ka ndonjë shoqe me ja qitë e po ashtu i kishte dhënë se sa mirë qenke veshur sot dhe sa mirë po të rrinë teshat.

Përmes deklaratës së nxënësve të paditësit e dt.06.11.2019, e dhënë nga M.R., gjykata vërtetoi faktin se nxënësja Sh.B., i ka rrëfyer shoqes së saj të klasës për sjelljet e profesorit R.M., ku e kishte kapë për krahu, pastaj edhe e kishte ngacmuar me fjalë, pastaj ka tentuar ta kapë për flokësh edhe nxënësen S., duke përfshirë edhe provokimet seksuale ndaj nxënësve.

Përmes deklaratës së dhënë nga S.R., gjykata vërtetoi faktin se profesori R.M., si ka hyrë në klasë ka shkuar me vrull tek nxënësja R. dhe e ka kapur për flokësh, ka ardhur pastaj tek S. e ka kapur për krahu dhe ka vazhduar tek B. ku e ka goditur fizikisht dhe e ka larguar nga klasa.

Përmes deklaratës së dhënë nga R.R., e dt.30.10.2018, gjykata vërtetoi faktin se profesori R.M., pasi kishte hyrë në klasë, kishte filluar të bërtasë dhe u nisë drejt nxënëses R.R., me qëllim për ta goditur me ditar, pastaj e kishte ulur me vrull, i ka goditur shoqet e saj si dhe B.. Shpesh profesori kishte kërkuar nga nxënëset që të vishen me përgaditje për orën e edukatës fizike por me që nuk kishin pranuar ai i'a kishte mbyllur notën e dobët Ri.. Në një rast tjetër profesori posa kishte hyrë në klasë kishte shkuar tek nxënëses R., i kishte bërtitur se pse nuk ishte ngritur në këmbë kur kishte hyrë profesori në klasë dhe e kishte kapë duke e shtrënguar fortë për qafe, ia kishte ngrehë flokët dhe pas kësaj kishte vazhduar me veprimet e tij të dhunshme tek nxënësit tjerë të klasës.

Përmes deklaratës së dhënë nga nxënësi F.R., gjykata vërtetoi faktin se edhe ndaj tij profesori kishte ushtruar dhunë fizike duke e goditur në bark.

Përmes deklaratës së nxënësve B.T. dhe F.H., gjykata vërtetoi faktin se në orën e edukatës fizike në oborrin e shkollës profesori kishte shkuar te to dhe kishte deklaruar se një vajzë aty në oborr po më pëlqen dhe kishte kërkuar nga to që ta vejnë në kontakt me premtimin se do t’iu jep para, ku ai kishte ra në kontakt me të njëjtin dhe i kishte dhënë para por që nuk i kishte realizuar qëllimet e tij dhe pas kësaj kishte ardhur tek B. dhe F., ku ju kishte treguar se ajo vajza i’a ka marrë paratë por nuk kishte dal me të, i ndjek në çdo vend që shkojnë duke iu thënë se ju jeni garantuese për atë vajzën me dal me profesorin në takim, ndërsa këto të fundit i kanë deklaruar profesorit se nuk e njohin atë vajzë vetëm e kanë parë tek oborri i shkollës dhe asgjë më shumë.

Përmes aktvendimit të Gjykatës Themelore në Ferizaj P.nr.441/2016, i dt.03.06.2016, gjykata vërtetoi faktin se të pandehurit R.M., në procedurë penale i është caktuar masa e zbatimit të ekzaminimit psikiatrik në kohëzgjatje prej 2 javësh nga data 03.06.2016 deri më dt.17.06.2016, ku për shkak të kryerjes së veprës penale lëndim trupor kundër nxënësit H.Sh., të kryer më dt.05.05.2016, gjatë marrjes në pyetje nga ana e gjykatës, i njëjti kishte manifestuar çrregullime mendore.

Përmes raportit nga Qendra Emergjente në Ferizaj, nr.1012, i dt.21.01.2019, gjykata vërtetoi faktin se mësimdhënësi He.Sh., kishte pësuar lëndime trupore si rezultat i sulmit nga kolegu i tij i punës R.M..

Përmes deklaratës së nxënësit F.P., e dt.10.03.2021, gjykata vërtetoi faktin se gjatë orës së edukatës fizike deri sa ishin duke luajtur volejball, nxënësit kishin filluar ta thërrisnin “O D. D.” nxënësi në fjalë pastaj i kishte kërkuar t’ia gjuante topin dhe kur kishte përfunduar ora, nxënësin F. dhe A., nuk i kishte lejuar të dalin nga salla e sportit, ua kishte mbyllur derën i kishte detyruar që të qëndrojnë me një këmbë për 15 minuta, pas kësaj i kishte futur në një zyre ku gjatë asaj kohe kishte qëndruar me një shkop në dorë duke i kërcënuar këta dy nxënësit duke ju thënë se ka për ti mbytur dhe pas këtij momenti i kishte mbyllur derën dhe kishte shkuar tek drejtori, ndërsa nxënësi nga frika kishte ikur përmes dritares.

Përmes njoftimit të lëshuar nga Drejtoria e Shkollës “Zenel Hajdini” nga Ferizaj, e dt.15.03.2021, gjykata vërtetoi faktin se Drejtoria e Shkollës “Zenel Hajdini”, e ka njoftuar Drejtorinë e Arsimit në Ferizaj, për sjelljet e mësimdhënësit R.M. ndaj nxënësve F. P. dhe A..

Përmes njoftimit të lëshuar nga Drejtoria e Shkollës “Zenel Hajdini” nga Ferizaj, i dt.23.01.2021, Drejtori e Shkollës “Zenel Hajdini” e ka njoftuar Drejtorinë e Arsimit në Ferizaj që mësimdhënësi R.M. e ka sulmuar fizikisht në klasë nxënësin P.K., e po ashtu e ka njoftuar se për rastin e njëjtë kanë hapur rast në polici.

Përmes ftesës për intervistë e lëshuar nga Drejtoria e Arsimit me nr.... e dt.29.11.2019, gjykata vërtetoi faktin se Drejtori i Shkollës A.I., e ka ftuar paditësin R.M. që të paraqitet në Drejtorinë e Arsimit në Ferizaj më dt.02.12.2019, në ora 10.00, për intervistim në procedurën disiplinore të zhvilluar ndaj tij.

Përmes vendimit të lëshuar nga Kryetari i Komunës 01.nr...., i dt.29.11.2019, gjykata vërtetoi faktin se është emëruar anëtari i tretë i Komisionit Disiplinor z. A...M..., për shqyrtimin e raportit disiplinor ndaj mësimdhënësit R.M..

Përmes ftesës për intervistë e lëshuar nga Drejtoria e Arsimit në Ferizaj me nr...., e dt.29.11.2019, gjykata vërtetoi faktin se Drejtori i Shkollës A.I..., e ka ftuar paditësin R.M., që të paraqitet në Drejtorinë e Arsimit në Ferizaj, më dt.02.12.2019, në ora 09.00, për intervistim në procedurën disiplinore të zhvilluar ndaj tij.

Përmes postës elektronike - emailit të dërguar më dt.20.02.2018, nga A.I., drejtuar B.B., i dt.27.11.2018, gjykata vërtetoi faktin se Drejtori i Shkollës i drejtohet përfaqësuesit të DKA-së në Ferizaj, ku e njofton se është hera e dytë që i shkruan email dhe e njofton se nga dërgimi i emailit të parë, mësimdhënësi R.M., i ka përsëritur sjelljet e tij të këqija në vendin e punës, ku i njëjti ka pasur edhe shumë raste tjera të konflikteve dhe përdorimit të dhunës fizike ndaj nxënësve si dhe konflikte verbale me mësimdhënësit e tjerë, ku javën e kaluar e ka sulmuar një nxënës të klasës së XII-të, i cili rast është regjistruar edhe nga kamerat e sigurisë. Përmes të njëjtit email, kishte kërkuar nga Drejtoria e Arsimit që të ndërmarrin masa adekuate ndaj këtij mësimdhënësi.

Përmes postës elektronike - emailit të dërguar më dt.20.02.2018, nga A.I., drejtuar B.B., i dt.20.02.2018, gjykata vërtetoi faktin se Drejtori i Shkollës “Zenel Hajdini” e njofton DKA-në në Ferizaj se mësimdhënësi R.M., demonstron sjellje të këqija dhe ushtron dhunë fizike ndaj nxënësve e madhje edhe dhunë verbale ndaj mësimdhënësve të tjerë, ku për rastin e ushtrimit të dhunës ndaj një nxënësi, i njëjti është në process gjyqësor, ku gjatë këtij procesi M., është dërguar

nga gjykata në ekzaminim psikiatrik dhe trajtim mjekësor për skizofreni paranoike. Përmes të njëjtit email e njofton Drejtorinë se mësimdhënësi M., ka tentuar që ta fuse me dhunë në klasë një nxënëse dhe nga këto arsye i propozon Drejtorisë së Arsimit që të ndërmerr hapa konkret ligjor ndaj mësimdhënësit R.M..

Provat e reja të cilat janë marrë në procedurë të ri- gjykimit, deklarata e paditësit e dt. 07.02.2022 e shkruar dhe nënshkruar nga paditësi dhe procesverbali- deklarata e dhënë para komisionit disiplinor dt. 26.03.2021, të cilat vërtetojnë se komisioni para marrjes në pyetje të paditësit kishte njoftuar mjekun për gjendjen e paditësit, e pastaj kishte pyetur paditësin se a po i mbante të gjitha orët mësimore, i njëjti para komisionit kishte deklaruar se nxënësit e kishin ngacmuar duke e thirrur me nofkën ‘D.’.

Përmes Aktvendimit penal P.nr. 441/2016, i dt. 15.08.2016, i cili është bërë i plotfuqishëm me dt. 27.09.2016, vërtetohet se ndaj paditësit është shqiptuar masa e trajtimit të detyrueshëm psikiatrik në liri e cila do të ekzekutohej nga Qendra e Shëndetit Mental për të rritur në Ferizaj.

Gjykata ka analizuar me kujdes bazën ligjore dhe arsyet ligjore dhe ka konstatuar se njoftimi për shkëputjen e kontratës së punës, shikuar në aspektin ligjor është në përputhje me Ligjin e Punës në Kosovë, i cili përcakton procedurat që duhet të udhëhiqen kur zbatohet neni 70 i Ligjit, i cili përcakton se punëdhënësi e njofton punonjësin me shkrim për qëllimin e tij për ta ndërprerë kontratën e punës, njoftimi duhet të përfshijë edhe shkaqet për shkëputjen e kontratës së punës nga i cili fakt rrjedh se e paditura i ka përfillur dispozitat ligjore-procedurale me rastin e njoftimit të paditësit për shkëputjen e kontratës së punës.

Gjykata ka gjetur se në bazë të nenit 70 par.1.4 pika 1.4.1. dhe 1.4.2. përcaktohet se kontrata e punës shkëputet nga punëdhënësi në rastet e rënda të sjelljes së keqe ose të përmbushjes së pakënaqshme të detyrave të punës. Se ekziston sjellja e keqe e mësimdhënësit, në këtë rast paditësit, këtë e vërteton edhe procedura penale ndaj të pandehurit R.M. në procedurë penale P.nr.441/2016, i datës 03.06.2016, për shkak të ushtrimit të dhunës fizike dhe shaktimit të lëndimeve trupore ndaj mësimdhënësit- kolegut të punës H.Sh., mandej gjykata ka vërtetuar faktin se tre vite më parë një vajzë në klasë nuk i kishte patikat për lëndën e edukatës fizike dhe kur të gjithë nxënësit kishin dalë nga klasa vetëm ajo qëndronte brenda dhe kishte refuzuar kërkesën e profesorit që të dilte jashtë, ku me këtë rast paditësi e kishte kapur për krahu që ta nxjerrte jashtë klasës por e njëjta kishte refuzuar dhe profesori kishte ndaluar pa e nxjerrë jashtë.

Sa i përket çështjes së përse kjo lëndë ishte kthyer në ri-gjykim nga Gjykata Supreme e Ksavoës, përmes revizionit të ushtruar nga përfaqësuesi i paditësit, gjykata edhe më tej në ri procedurë nuk arriti të vërtetonte një gjendje tjetër faktike mbi të cilën do të bazohej e drejta e paditësit, edhe pas rigjyimit dhe pas ndjenjes së udhëzimeve të dhëna nga gjykata e shkallës së tretë, gjykata e shkallës së parë është e bindur se procedura administrative lidhur me shqiptimin e masës disiplinore e deri tek ndërprerja e marrëdhënies së punës së paditësit ishte zbatuar konform dispozitave ligjore dhe pa ndonjë mungesë faktike- eventuale andaj nga kjo rrjedhë se gjykata e shkallës së parë edhe në riprocedurë pas shiqimit të shkresave-provave të procedurës disiplinore dhe shkresave tjera në origjinal të deponuara nga e paditura mban qëndrim të njëjtë sa i përket këtij kontesti juridik nga marrëdhënia e punës.

Pretendimet e paditësit se nuk janë respektuar procedurat disiplinore, ngase nuk është udhëhequr procedura disiplinore nuk qëndrojnë ngase në bazë të rregullores mbi përgjegjësinë disiplinore të punëdhënësit si dhe në bazë të dispozitave të vet Ligjit të Punës në Kosovë, të cilat kanë paraparë procedura disiplinore, të cilat në rastin konkret janë respektuar dhe zbatuar, për shkak se ekziston njoftimi nr...., i datës 29.11.2019, përmes së cilës i njëjti është njoftuar se me datën 02.12.2019, ditë e hënë në drejtorin e arsimit do të mbahet intervista me gojë pranë komisionit disiplinore për shkeljet disiplinore rreth rastit të paditësit, mandej të njëjtit me vendimin nr...., të datës 06.04.2021, i është ndërprerë marrëdhënja e punës dhe atë pas shqyrtimit të vërejtjeve paraprake, të drejtorisë së shkollës, mandej vërejtjeve të drejtorit aktual të sjella në komision disiplinor, pas intervistimit të palës nga komisioni me datë 26.03.2021 dhe duke u bazuar në komplet dokumentacionin e dosjes së komisionit disiplinor dhe atë pas nxjerrjes së vendimit mbi ndalimin e çasjes së mësimdhënësit-paditësit në objektin e shkollës SHML “Zenel Hajdini” në Ferizaj, të cilat prova gjenden në shkresa të lëndës.

Lidhur me shpenzimet e procedurës, gjykata ka vendosur në bazë të nenit 450 të LPK-së, ku secila palë e bartë shpenzimet e veta të procedurës.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij e aktgjykimit.

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ,

2023:289240, më datë 03.06.2024

Gjyqtari,

Numri i lëndës: 2021:099202
Datë: 10.06.2024
Numri i dokumentit: 05845297

Bekim Salihu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të ushtrohet ankesa në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit, në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, përmes kësaj Gjykate.